



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.501/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Skenderaj, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me shenjen ZL.A.nr.501/2017 e datë 24.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga s subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me të cilën ka pretenduar se me datë 23.10.2017, rreth orës 18:00, sipas vëzhguesit të PDK-së Valmir Veseli, në fshatin Ticë, kandidati ynë Gazmend Doni kishte 12 vota ndërsa nga lista e zyrtarëve që kemi marrë në KKZ del se ka vetëm një votë. Më tej ka theksuar se ka mospërputhje në mes të raporteve që kanë marr nga komisionerët dhe vëzhguesit e rezultateve që ka publikuar KKZ-ja.

Ankesës ia ka bashkangjitur listën e Qendrave të votimit për të cilat ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në ato Qendra të votimit.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës e subjektit politik LVV, dega në Skenderaj, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.501/2017 më datën 25.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.